

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**(Auditim Tematik)**

**“Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2021, në  
Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura”**

**Maj 2022**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË  
LËNA NË VITIN 2021Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONA VE TË MBROJTURA

<b>PËRMBAJTJA</b>			
<b>I.</b>	<b>Përmbledhje Ekzekutive</b>	1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit	<b>3-4</b>
		2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
		3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit	
<b>II.</b>	<b>Hyrja</b>	1. Objektivi i Auditimit	<b>4-6</b>
		2. Qëllimi i Auditimit	
		3. Identifikimi i çështjes	
		4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
		5. Përgjegjësitë e audituesve	
		6. Kriteret e vlerësimit	
		7. Standardet e auditimit	
		8. Metodatat e auditimit	
		9. Dokumentimi i auditimit	
<b>III</b>	<b>Përshkrimi i auditimit</b>	<b>6-13</b>	
<b>1</b>	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	<b>6</b>	
<b>2</b>	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	<b>5</b>	
<b>2.1</b>	Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, ËPër Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.	<b>6</b>	
<b>2.2</b>	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	<b>7</b>	
<b>2.3</b>	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	<b>7-13</b>	
<b>2.4</b>	Zbatimi i rekomandimeve për shpërbllimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	<b>13</b>	
<b>2.5</b>	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	<b>13</b>	
<b>2.6</b>	Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.	<b>14</b>	
<b>IV.</b>	<b>Gjetje dhe rekomandime</b>	<b>14</b>	



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 ËNË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONAVE TË MBROJTURA

## I. Përmbledhje ekzekutive

### 1. Përshkrim i shkurtër i raportit të auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*) ushtroi auditim tematik në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që lidhen me verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, përcjellë me shkresën nr. 402/8prot, datë 30.7.2021. Kjo shkresë është protokolluar në AKZM me nr.886 prot., datë 02/08/2021.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt-konstatim sipas çështjeve respektive të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmblyës me përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

### I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon:

Lidhur me zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, nga analiza e strukturës së institucionit dhe punonjësve me kontratë të AKZM -së konstatohet se për periudhën objekt auditimi për muajt e zgjedhur nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve si të strukturës, ashtu dhe pranimet në punë kërkohet bëhen në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 i ndryshuar òKod i punës, ndërsa në VKM nr.102, datë 04.02.2015, òPër krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura ò në kreu V, pika 2, òProcedura e rekrutimit ò përcaktohen se: òMarrëdhëniet e punës së punonjësve të administratave të zonave të mbrojtura rregullohen sipas Kodit të Punës; ndërsa pika 3 shpreh: òKriteret dhe përshkrimi i vendeve të punës për punonjësit e administratave të zonave të mbrojtura miratohen nga Ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura , me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

Gjatë auditimit nuk u paraqit ndonjë dokument për Kriteret dhe përshkrimin e vendeve të punës për punonjësit e administratave të zonave të mbrojtura, i miratuar nga Ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura, por as në rregulloren e AKZM òRregullorja e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe e Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura ò, miratuar me urdhrin nr.72/1, datë 15.06.2015 të Ministrisë Mjedisit në të cilën përshkruhen detyrat për çdo vend pune, nuk përmenden kriteret për punësimin në AdZM. me kontratë të përkohshme.

Është nxjerrë urdhrin nr. 23, datë 21.01.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm për kryerjen e inventarizimit fizik të Aktiveve, mbi bazën e Memo-s , datë 21.01.2021, ku referuar pikës 81, të udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik ò janë paraqitur inventarët kontabël më datë 31.12.2020, për të kryer krahasimin e aktiveve kontabël me gjendjen e tyre fizike (me përjashtim të inventarit kontabël të magazinës).

Konstatohet se nuk është kryer inventarizimi fizik i magazinës.

Përveç kësaj konstatohet se nuk është paraqitur inventari kontabël dhe nuk është kryer inventarizimi fizik i llogarisë 211 òPyje, Plantacione ò në bilanc 41,608,077;

Nuk është paraqitur inventari kontabël dhe nuk është kryer inventarizimi fizik i llogarisë 213 òRrugë, rrjete, vepra ujore ò në bilanc 23,684,492 lekë.

Për vitin 2020 janë kryer inventarizimet me komisione (përveç inventarit të aktiveve qarkulluese, llogarisë 211 òPyje, Plantacione ò dhe llogarisë 213 òRrugë, rrjete, vepra ujore ò) dhe nuk rezultojnë të jete ngritur komision për nxjerrje jashtë përdorimit dhe për ekzekutimin, si dhe nuk rezultojnë që komisioni të ketë bërë relacion përmbledhës për drejtuesit e Institucionit për gjendjen e aktiveve materiale e jo material, në kundërshtim me nenin 6, germa (e) të Ligjit Nr.10296, datë 08/07/2010, òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ò, UMF nr.30, datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiveve në sektorin publik ò, i ndryshuar, pikat 104/c dhe 106.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 ËNË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONAVE TË MBROJTURA

Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi komisionet e inventarizimit në qarqe. Gjithashtu nuk rezulton të jete kryer ndonjë procedurë për vlerësimin e aktiveve sipas UMF nr.30, datë 27.12.2011 ëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë pika 95 ku është përcaktuar se:

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, në 8 raste, për shumën 29,294 lekë, sipas urdhërshpenzimeve nr. 289, datë 05.11.2019, nr. 259, datë 09.10.2019, nr.238, datë 09.09.2020, nr.226, datë 02.09.2020, nr.363, datë 23.11.2020, nr.351, datë 18.11.2020, nr.343, datë 13.11.2020, nr.336, datë 10.11.2020, ka likuiduar DRSHTRR-të në rrethe për pagesa gjobash për vonesa, brenda vlerës së përgjithshme, sipas dokumenteve për taksa makine, gjoba për te cilat duhej të nxirrej përgjegjësia dhe të paguheshin prej personave përgjegjës, për rrjedhojë nuk duhej të paguhej shuma prej prej 29,294 lekë nga AKZM.

### I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit

Nga 37 rekomandime të lëna gjithsej nga KLSH, 28 masa ose 75.6% janë zbatuar, 7 masa ose 19% janë në proces zbatimi, 1 masë ose 2.7% nuk është zbatuar dhe 1 masë ose 2.7% është zbatuar pjesërisht.

Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit është si vijon:

-Për përmirësimin e gjendjes nga 30 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 24 rekomandime, 4 rekomandime janë në proces zbatimi, 1 rekomandim i pazbatuar dhe 1 rekomandim është zbatuar pjesërisht.

-Për masa shpërbllim dëmi janë lënë 3 rekomandime në vlerën 9,300 mijë lekë nga të cilat 1 është zbatuar, 2 në proces, nga të cilat 1 masë është e natyrës e ardhur e munguar në vlerë 9,121 mijë.

-Për masat 3E, është rekomanduar 1 masë, e cila është në proces.

-Për masat disiplinore, janë zbatuar 3 masa.

## II. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2021, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: verifikimin e respektimit të afatit 20-ditor dhe 6-mujor për kthim përgjigje mbi përgatitjen e plan-veprimit dhe informacionin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve; verifikimin e nivelit të zbatimit të masave për përmirësim ligjor, organizative, të ardhura të munguara dhe masave disiplinore.

Sipas Programit të Auditimit, nr. 162/4 datë 14.02.2022, auditimi u krye nga grupi auditues, si vijon:

1. A.M, Përgjegjës Grupi
2. L.K, auditues
3. O.L, auditues
4. R.A, auditues

### Titulli

Raport Përfundimtar Auditimi mbi verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2021 të kryer në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

### Marrësi

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM).

### Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Ky auditim ka objektiv pasqyrimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm të kryer pranë AKZM si dhe dhënien e opinionit objektiv e profesional mbi zbatimin e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONA VE TË MBROJTURA

rekomandimeve të dërguara nga KLSH në përmirësimin e punës menaxhuese të njësisë publike. Gjithashtu ka si qëllim raportimin mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit.

### Identifikimi i Çështjeve

*Për vitin 2019*, u evidentuan të planifikuara shpenzime operative dhe për investime.

Në shpenzimet operative përdorimi i tyre ishte: Shërbim Ruajtje, Karburant, Riparim automjetesh, furnizime për printera, ujë, energji elektrike, taksa dhe siguracion automjetesh. Shpenzimet për investime janë kryer në dy procedura prokurimi në total fond limit 47.000 milion lekë me TVSH .

*Për vitin 2020*, shpenzimet operative janë pothuajse në nivelet e vitit 2019. Fondi për investime është prokuruar në tre procedura me fond limit total 69,860 milion lekë me TVSH.

*Për vitin 2021*, niveli i shpenzimeve operative është rritur në krahasim me dy vitet e mëparshme e shoqëruar kjo dhe me një rritje të aseteve nga ish ISHMPUT, kjo sipas urdhrat të ministrit nr. 54, datë 24.02.2020 për kalim në përgjegjësi administrimi të godinave, automjeteve dhe inventarit ekonomik të ISHMPU qendër dhe Degëve Rajonale të saj, tek institucione të tjera të varësisë së MTMö. Shpenzimet për investime janë planifikuar për 5 procedura, nga të cilat 4 ishin realizuar me fond total limit 160,745 milion leke me TVSH.

Nga auditimi i blerjeve me vlera të vogla për periudhën objekt auditimi u konstatua se janë kryer procedurat për blerje për 12 Administratat e zonave të mbrojtura ( ADZM) në 12 qarqe, dhe me së shumti objekti i prokurimit ishte, kancelari, internet, vaj filtra mjetesh, taksa kolaudime etj..

1. *Për vitin 2019* AKZM ka parashikuar 15 procedura prokurimi me vlera të vogël, me fond prej 7,722,000 lekë me TVSH , nga të cilat janë realizuar të 15-ta me fondin 5,861,778 leke me TVSH.

2. *Për vitin 2020* AKZM ka parashikuar 17 procedura prokurimi me vlera të vogël, me fond prej 11,696,980 lekë, me TVSH nga të cilat janë realizuar 16 procedura me fondin limit 9,626,177 lekë me TVSH.

3. *Për vitin 2021* AKZM ka parashikuar 16 procedura prokurimi me vlera të vogël, me fond prej 11,985,350 lekë, nga të cilat janë realizuar deri me 31.03.2021, gjithsej 12 procedura, me fondin 7,358.887 lekë.

### Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, funksion në zbatim nr. Ligji nr. 81/2017 për Zona të Mbrojtura të rregullores së brendshme si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, kanë për objektiv:

- Miraton projekt programimi buxhetor afatmesëm dhe projekt programin vjetor të veprimtarisë së vitit të ardhshëm financiar, të cilat ia propozon ministrit përgjegjës për financat, si dhe kontrollon çdo tre muaj drejtimet e përgjithshme të veprimtarisë financiare të Agjencisë;
- I propozon ministrit përgjegjës për financat miratimin të buxhetit të Agjencisë; Miraton rregulloren për organizimin dhe administrimin e zonave të mbrojtura si dhe të të dhënave të tjera që administron AKZM-ja;
- Miraton raportin vjetor të veprimtarisë, AKZM ója shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin në Republikën e Shqipërisë sipas rrejtit të zonave të mbrojtura , drejton hartimin e dokumenteve strategjike për zonat e mbrojtura , konsulton propozon dhe bashkëpunon me strukturat e Ministrisë së Mjedisit;
- Propozon ndryshime të kuadrit ligjorë dhe rregullatorë , bënë Administrimin e pasurisë së paluajtshme shtetërore dhe publike të cilat i kalohen në përgjegjësi administrimi, bashkëpunon dhe harton programe për monitorimin e zonave të mbrojtura.

### Përgjegjësitë e audituesve:

Grupi i auditimit të KLSH<sup>së</sup>, për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, ka zbatuar Kodin e Parimet



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË  
LËNA NË VITIN 2021Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONAVE TË MBROJTURA

Etike të cilat drejtojnë përgjegjësitë profesionale të audituesit dhe Standardet e Miratuara të Auditimit duke patur në qendër të vëmendjes: kryerjen e procedurave të nevojshme për të siguruar dëshmi e evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për të mbështetur konkluzionin tonë. Procedurat e kryera janë bazuar në gjykimin profesional të audituesve, duke përfshirë vlerësimin e riskut të mospërputhjeve materiale, qofshin këto për shkak të mashtimit apo gabimit. Vlerësimi i transparencës me publikun, krahasimi i rezultateve të veprimtarisë së institucionit midis viteve objekt i auditimit. Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës. Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, shlyerjen e dëmeve të mundshme ekonomike dhe parandalimin e mospërputhjeve në të ardhmen.

Ne besojmë se provat e mbledhura të auditimit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur konkluzionin tonë.

## **Kriteret e vlerësimit:**

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së.
- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.

## **Standardet e auditimit**

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Raporti Përfundimtar i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

## **Metodat e auditimit**

1. Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.
2. Verifikimi i Urdhrave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

## **Dokumentimi i rezultateve të Auditimit**

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar është përgatitur Raporti Përfundimtar i Auditimit

## **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim**

**Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura**, ka për objekt të veprimtarisë:

Agjencia Kombëtare e zonave të mbrojtura është krijuar me Vendimin nr. 102 datë 04.02.2015, òPër Krijimin dhe mënyrën e organizimit e Funksioneve të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura. Ligji nr. 81/2017 për Zonat e Mbrojtura; Vendim nr. 593, date 9.10.2018, òPër përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura mjedisore -Kujdesi ndaj natyrës dhe biodiversiteti nëpërmjet menaxhimit të zonave të mbrojtura, me interes kombëtare dhe e ndërkombëtare, mbledhjes dhe shpërndarjes dhe edukimi mit mjedisore dhe ndërgjegjësimi të publikut.

- Veprimtaria buxhetore dhe financiare e AKZM -së i nënshtrohet legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Buxheti i AKZM miratohet nga Ministria e financave me





# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONA VE TË MBROJTURA

propozim të ministrit përgjegjëse .Të ardhurat, që do të rezultojnë të papërdorura në fund të vitit financiar, trashëgohen në buxhetin e vitit ushtrimor pasardhës të cilat nuk përdoren nga vetë AKZM .

## 2.1. Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga auditimi u konstatua se:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 402/8prot, datë 30.7.2021 ka dërguar në AKZM Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse. Kjo shkresë është protokolluar në AKZM me nr.886 prot., datë 02/08/2021
- Nga titullari i institucioni është nxjerrë Urdhër për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, por për zbatimin e tyre janë marrë masa nga specialistët e të gjithë sektorëve përkatës të prekur në Raportin Përfundimtar të KLSH, rast pas rasti sipas detyrave të gjithsecilit.
- Me shkresë nr.886/1 datë 27.08.2021 nga ana e AKZM është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.
- **Shkalla e zbatimit:** Ky detyrim ligjor është zbatuar.

### Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse nr. 402/8 prot, datë 30.7.2021 janë lënë **34 rekomandime** gjithsej, nga këto: **30 masa organizative, 3 masa zhdëmtimi në vlerën 9,300 lekë dhe 34 masë 3 E 3,132 mijë lekë.**

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes nga 30 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 24 rekomandime, 4 rekomandime janë në proces zbatimi, 1 rekomandim i pazbatuar dhe 1 rekomandim është zbatuar pjesërisht.
- Për masa shpërblim dëmi janë lënë 3 rekomandime në vlerën 9,300 mijë lekë nga të cilat 1 është zbatuar, 2 në proces, nga të cilat 1 masë është e natyrës e ardhur e munguar në vlerë 9,121 mijë.
- Për masat 3E, është rekomanduar 1 masë, e cila është në proces.
- Për masat disiplinore, janë zbatuar 3 masa.

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :					Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike										
		Rekomandimi gjithsej	Nga rekomandimet janë:				Pjesërisht	Rekomanduar Gjithsej		Nga rekomandimet janë:							
			Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar	Pjesërisht		Nr. per	Në mijë/lek	Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht (në proces)		Pa zbatuar			
										Nr. per	Në mijë/lek	Nr. Per s	Në mijë/lek	Nr. per s	Në mijë/lek		
1.	Masa organizative	30	24	4	1	1											
2.	Masa për përmirësim ligjor																
3.	Shpërblim dëmi	3	1	2													
4.	Masa 3E	1		1													



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONA VE TË MBROJTURA

5.	Masa disiplinore	3	3											
	<b>Totali</b>	<b>37</b>	<b>28</b>	<b>7</b>	<b>1</b>	<b>1</b>								

**2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi.** Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Duke qenë se nuk janë lënë rekomandime për përmirësime ligjore nga auditimi i mëparshëm i KLSH atëherë kjo pikë e programit ezaurohet me këtë shënim.

**2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ.**

**Rekomandim 1:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, të hartojnë Projekt buxhete PB dhe PBA, parashikimin e numrit dhe të kostove të produkteve për realizimin e plotë të tyre në mënyrë që mos të rezultojë një situatë kontradiktore ku fondet e planifikuara dhe të alokuara të mos realizohen.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi evidentohet në evidencën e muajit dhjetor të vitit 2021 ku realizimi i fondeve buxhetore është në masën 100%.

**Rekomandim 2:** Njësite e Qeverisjes Vendore si institucion Ligj zbatues të krijojë Data ó Base mbi ndërtimet in formalë në Zonat e Mbrojtura si dhe zhvillojë një komunikim shkresor me njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Institucionet Ligj Zbatuese dhe ASHK-në për të parandaluar ndërtimet në ZM në shkallë vendi.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi është dërguar shkresa me nr.1175, datë 28.9.2021 të gjitha Bashkive, ASHK-ve dhe për dijeni AdZM-ve duke kërkuar bashkëpunim dhe informacion mbi ndërtimet informale në ZM.

**Rekomandimi 3:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë të marrë masat për evidentimin dhe regjistrimin në Kadastër të pronave publike të aprovuara me VKM në Zonat e Mbrojtura.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht. Në zbatim të këtij rekomandimi është ndjekur procesi i Miratimit të VKM-ve që përcaktojnë qartë kufizimin dhe hartëzimin e ZM, me përfundimin e tyre do të ndiqet aplikimi për rregjistrim në Kadastër.

**Rekomandimi 4:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë dhe ADZM Dibër të marrë masa dhe të bashkëpunoje me të gjitha institucionet ligj zbatuese për Zonave të mbrojtura me njoftime periodike shkresore pranë IKMT dhe ASHK për ndjekjen procedurave ligjore në të gjitha ato zona ku ka objekte të ndërtuara jashtë ligjit.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

**Rekomandimi 5:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me AdZM Tiranë, Dibër, Korçë dhe Shkodër të hartojë një Data-Base me gjithë informacionet për ndërtimet informale dhe të marrë masa dhe të bashkëpunoje me të gjitha institucionet ligj zbatuese për Zonave të mbrojtura me njoftime periodike shkresore pranë IKMT dhe ASHK për ndjekjen procedurave ligjore në të gjitha ato zona ku ka objekte të ndërtuara jashtë ligjit.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË  
LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONA VE TË MBROJTURA

**Rekomandimi 6:** Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë të marrë masa për plotësimin e dokumentacionin e kërkuar ligjor në 7 raste për miratimet e dhëna për pajisjen me leje legalizime të ndërtimeve in formalë dhe në rastin e mos plotësimit të dokumentacionit ligjor të veprohet me njoftime shkresore pranë IKMT dhe ASHK për ndjekjen procedurave ligjore në objektet të ndërtuara në zona të mbrojtura pa dokumentacionin e kërkuar ligjor.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces**.

**Rekomandimi 7:** AKZM të marrë masa për të krijuar data-base për florën e faunën për çdo zonë të mbrojtur në territorin e Shqipërisë si dhe të krijojë një regjistër me të dhënat e nevojshme për ndjekjen e situatës dhe zbatimin të planit të menaxhimit për çdo zonë mbrojtur në çdo AdZM.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Në zbatim të këtij rekomandimi është krijuar data baze për florën dhe faunën për çdo zonë të mbrojtur kjo nëpërmjet një sistemi elektronik i cili gjendet lehtësisht në linkun [Http://bionna.al](http://bionna.al).

**Rekomandimi 8:** AKZM dhe AdZM-të të marrin masa që brenda kuadrit ligjor dhe reciprocitetit institucional të kryejnë bashkëpunime me Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Drejtoritë e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës që ta ndalë procesin e degradimit dhe ndotjes si dhe përdorimin pa kriter e pa leje të peshkimit.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Në zbatim të këtij rekomandimi është bërë bashkëpunimi me Bashkinë Shkodër nëpërmjet akt marrëveshjes me të dyja palët AdZM dhe Bashkia Shkodër. Me bashkinë Vlorë problemi është diskutuar nëpërmjet takimeve të Komitetit të Menaxhimit ku kryhet periodikisht e herë në vit në praninë e Prefektit të Qarkut.

**Rekomandimi 9:** AKZM në bashkëpunim e koordinim me AdZM-të të marrë masa për të vendosur, caktuar dhe kufizuar sipas standardit ligjor zonat buferike në rezervatet natyrore Kune-Vain, Rrushkulli, Pishë Poro, Karaburun, Ksamil, Divjakë etj., në funksion të ruajtjes dhe përmirësimit të funksioneve natyrore të tyre.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Nga evidentimi i zonimit të zonave të mbrojtura është konkluduar se .. Kune-Vain, Rrushkulli, Pishë Poro, Karaburun, Ksamil, Divjakë, nuk rrethohen nga asnje zonë buferike.

**Rekomandimi 10:** Drejtori i Përgjithshëm i AKZM Tiranë të marrë masa dhe të përgatisë dhe të paraqesë për miratim tek Ministri dokumentin *“Kriteret dhe përshkrimi i vendeve të punës për punonjësit e administratave të zonave të mbrojtura (AdZM) ò*.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Në zbatim të këtij rekomandimi është Dërguar për aprovim në MTM Rregullorja e Brendshme e funksionimit ku anekse të së cilës janë edhe , Kriteret dhe përshkrimi i vendeve të punës për punonjësit e administratave të zonave të mbrojtura (AdZM) ò.

**Rekomandimi 11:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrë masa, që gjatë përlllogaritjes së vlerës së fondit limit t’ referohen kuadrit rregullativ ligjor me qëllim llogaritjen e saktë të vlerës së kontratës.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë për çdo procedurë prokurimi janë ngritur Komisionet e justifikimit të fondit Limit dhe hartuar proces verbalet e tyre.

**Rekomandimi 12:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të hapë dhe të mbajë librat analitikë të ardhurave dhe shpenzimeve, ditarin e veprimeve të ndryshme, ditari i pagave, dhe të gjithë ditarët e tjerë, analizat, centralizatori / libri i madh. Në ditarin e Bankës, regjistrimet kontabël të kryhen në llogaritë



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË  
LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONA VE TË MBROJTURA

financiare dhe të llogarive të tjera, sipas veprimeve dhe ngjarjeve konkrete, dhe të mos kalohen në çdo rast direkt në shpenzime. Për pasqyrat financiare, të përgatiten inventarët dhe analizat sipas posteve të bilancit.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë urdhri 160, datë 30.8.2021, “për mbajtjen e librave analitik të të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe gjithë ditarët e tjerë në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit në sektorin publik”, në zbatim të këtij urdhri është bërë mbajtja e tyre.

**Rekomandimi 13:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa dhe të rregullojë mos akordimet e përmendura në llogarinë 214-Instalime teknike, makineri e pajisjeë për diferencën 388,747 lekë. Në të ardhmen pas kryerjes së inventarizimeve, komisioni të bëjë relacion përmbledhës për drejtuesit e Institucionit mbi gjendjen e aktiveve materiale e jo materiale si dhe për diferencat e rezultuara dhe ngrihet komisioni për nxjerrje jashtë përdorimit dhe për ekzekutimin e Aktiveve. Institucioni çdo fund viti të përgatisë inventarët kontabël për të gjithë pasurinë në administrim të tij.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Në zbatimin e këtij rekomandimi është bërë reflektimi i rregullimit në bilancin e vitit 2021 i cili është mbyllur gjatë kohës së ndjekjes së rekomandimeve.

**Rekomandimi 14:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen dhe të kryejë të gjithë inventarët fizikë duke përfshirë inventarizimin fizik të magazinës, inventarizimin fizik të llogarisë 211 òPyje, Plantacioneë në bilanc 41,608,077 dhe inventarizimin fizik të llogarisë 213 òRrugë, rrjete, vepra ujoreë në bilanc 23,684,492 lekë. Pas kryerjes së inventarizimeve, komisioni të bëjë relacion përmbledhës për drejtuesit e Institucionit mbi gjendjen e aktiveve materiale e jo materiale si dhe për diferencat e rezultuara dhe ngrihet komisioni për nxjerrje jashtë përdorimit dhe për ekzekutimin e Aktiveve. Institucioni çdo fund viti të përgatisë inventarët kontabël për të gjithë pasurinë në administrim të tij, duke përfshirë inventarin e llogarisë 211 òPyje, Plantacioneë dhe llogarisë 213 òRrugë, rrjete, vepra ujoreë.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Në zbatimin e këtij rekomandimi është bërë reflektimi i rregullimit në bilancin e vitit 2021 i cili është mbyllur gjatë kohës së ndjekjes së rekomandimeve.

**Rekomandimi 15:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për krijimin dhe përmirësimin e regjistrit kontabël të aktiveve dhe të mos mjaftohet vetëm me përmbledhëset e inventarëve kontabël e fizikë të paraqitur bashkëlidhur bilancit. Në kartelat e AAMGJ, të paraqiten sa më shumë të dhëna, ku kërkesat minimale të jenë: data e hyrjes, vlera e blerjes, data e daljes në përdorim, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes etj.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë mbajtur dhe evidentuar të dhëna të detajuara për aktivitetet dhe historikun e tyre duke krijuar kartela për çdo aktiv. (Automjete dhe godina).

**Rekomandimi 16:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen dhe në çdo rast kontabilizimi të vendimeve gjyqësore që kanë kaluar në Shkallë të II-të (Gjykatën e Apelit), të bëhet në llogarinë e provizioneve.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË  
LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONAVE TË MBROJTURA

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Reflektuar në pasqyrat financiare të vitit 2021.

**Rekomandimi 17:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për të ardhmen të kryejë kontabilizimet në llogarinë kontabël 218 ÷ Inventar ekonomik, llogari që duhet të përfshihet në pasqyrat financiare.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Reflektuar në pasqyrat financiare të vitit 2021

**Rekomandimi 18:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen dhe të kryejë në fillim të vitit ushtrimor kontabilizime në llogaritë: Debi 520 ÷ Disponibilitete në Thesarë dhe Kredi 476 ÷ Të ardhura të caktuara për t'u përdorur si dhe në fund të vitit ushtrimor, për përdorimin e fondeve buxhetore korrent dhe kapitale, sipas situacionit të rakorduar me thesarin, veprimet me llog. 476 dhe 720 ÷ Grant korrent i brendshëm; 105 ÷ Teprica e granateve kapitale të brendshme dhe 4342 ÷ Operacione me shtetin (të drejta) ÷.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Reflektuar në pasqyrat financiare të vitit 2021.

**Rekomandimi 19:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen lidhur me ditarin e llogarive të magazinës dhe të kryejë kontabilizimet e rregullta në llogaria 603 ÷ Ndryshimi i gjendjeve e cila duhet të preke në ÷ Debi ÷ dhe ÷ Kredi me kundër parti llogaritë inventari ale të klasës 3 ÷ Aktive Qarkulluese ÷.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Reflektuar në mbajtjen e llogarive të ditarit të magazinës të llog 603 ÷ Ndryshimi i gjendjeve ÷.

**Rekomandimi 20:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen lidhur me paraqitjen e llogarive të amortizimit dhe në pasqyrat financiare të evidentojë shumat e akumuluar të amortizimit, në llogaritë 209 dhe 219, dhe të evidentohet llogaria 1013. Llogaria nr. 681, të evidentojë saktësisht shumat vjetore të amortizimit të AAGJ.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Reflektuar në pasqyrat financiare dhe anekset të bilancit të vitit 2021.

**Rekomandimi 21:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa dhe të rregullojë mos rakordimet e përmendura në totalin e shpenzimeve për diferencën 13,245,154 lekë.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Reflektuar në pasqyrat financiare të vitit 2021.

**Rekomandimi 22:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen dhe në asnjë rast të mos pranojë për likuidim fatura tatimore të cilat nuk janë konfirmuar nga AKZM, në rubrikën e caktuar të faturës Blerësi/Klienti dhe si të tilla nuk plotësojnë kushtet për të qenë një dokument vërtetues i mirëfilltë.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Ndjekur deri në hyrjen në sistemin fiskal të faturimit.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË  
LËNA NË VITIN 2021Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONA VE TË MBROJTURA

**Rekomandimi 23:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen dhe në asnjë rast të mos pranojë për likuidim fatura tatimore për kontrata prokurimesh, të cilat nuk janë konfirmuar nga AKZM, në rubrikën e caktuar të faturës Blerësi/Klienti dhe si të tilla nuk plotësojnë kushtet për të qenë një dokument vërtetues i mirëfilltë

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Ndjekur deri në hyrjen në sistemin fiskal të faturimit.

**Rekomandimi 24:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen lidhur me prokurimet e fondeve të ndërtimit dhe për çdo rast ndryshimi domethënës në volumet e punimeve të kryera nga preventive në stacione, të mbahen proces-verbale në mes operatorit ekonomik, mbikëqyrësit dhe investitorit (AKZM) duke reflektuar dhe duke bërë ndryshimet në kontratë dhe projekt.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Ndjekur dhe zbatuar në punimet e kontratës së zbatimit tek “Syri i kaltër”.

**Rekomandimi 25:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa dhe të kryejë akordimin e llogarive midis inventarit kontabël dhe fizik, të llogarisë 212 òndërtesa e Konstruksioneò për 15 objekte ndërtimore, dhe llogarisë 215 òmjete Transportiò për 27 mjete transporti.

**Koment: I zbatuar.**

**Rekomandimi 26:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për çdo fletë dalje të bashkëlidhë urdhërdorëzime, fletëkërkesat, plani i shpërndarjes e kartelës limit dhe në çdo rast fletë daljet të nënshkruhen nga marrësi në dorëzim i aktiveve.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Ndjekur dhe zbatuar në për të gjitha fletëdaljet me urdhër dorëzimet sipas rastit si dhe janë nënshkruar nga marrësi në dorëzim”.

**Rekomandimi 27:** Nga AKZM të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për te bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për 8 subjekte në shumën **9,121,759 lekë**, të evidentuara në tabelën si më poshtë vijon.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe në proces. Nga ana e AKZM janë duke u përgatitur shkresat përkatëse si dhe do merren masa për rakordimin mes sektorit të menaxhimit dhe sektorit të financës.

**Rekomandimi 28:** Nga AKZM të merren masa për hartimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e pikave të hyrjes së vizitorëve dhe automjeteve në monumentin e natyrës, objekti i rregullores duhet të jetë mbi:

1. Mbajtjen e korrespondencës dhe administrimin e dokumenteve të krijuara apo të ardhura në adresë të Administratave Rajonale të Zonave të mbrojtura. dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

2. Përgjegjësitë e AKZM-së dhe AdZM-ve përkatëse në administrimin e këtij procesi.

Përcaktimin e procedurës për arkëtimin e të ardhurave nga pikat e hyrjes së vizitorëve dhe automjeteve në zonat e mbrojtura.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **rezulton i pazbatuar**.

**Rekomandimi 29:** AKZM Njësia e prokurimit të marrë masa që të hartimin e fondit limit të kryej saktë analizë të kostos për këtë shërbim, sipas Termave të Referencës me zërat e kostos të përberë nga Kosto ekspertesh, kosto administrative dhe kosto aktivitetesh.





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË  
LËNA NË VITIN 2021 Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONA VE TË MBROJTURA

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.** **Për të gjitha procedurat është ngritur grupi i punës për llogaritjen e fondit limit kjo sipas rasteve të kryerjes së shërbimeve apo mallrave. Fondi limit për projektet është bërë me procedura të blerjeve te vogla nëpërmjet subjekteve të specializuara.**

**Rekomandimi 30:** AKZM Tiranë të marrë masa dhe në çdo tender që prokurohet nga Institucioni në dokumentet standarde të përshkruaj sipas objektit të prokurimit specifikimet teknike, në mënyrë që mos të ketë diskriminim të operatorëve ekonomik.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.** Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë janë ngritur Komisionet e Hartimit të DST dhe për të gjitha rastet janë mbajtur proces verbal të justifikimit të përdorimit të çdo kriteri teknik.

**2.4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërbllimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve:** sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

**Rekomandimi 1.** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të ndjekë të gjithë rrugët ligjore për arkëtimin e shumës **29,294\_lekë** sipas urdhër-shpenzimeve nr. 289, datë 05.11.2019, nr. 259, datë 09.10.2019, nr.238, datë 09.09.2020, nr.226, datë 02.09.2020, nr.363, datë 23.11.2020, nr.351, datë 18.11.2020, nr.343, datë 13.11.2020, nr.336, datë 10.11.2020, për pagesa gjobash për vonesa në pagesën e taksave.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.** **Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë urdhri me nr. 211 datë 28.9.2021 “Për kthimin e shumave të evidentuara si pagesa gjobash nga personat përgjegjës.**

**Rekomandimi 2.** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të ndjekë të gjithë rrugët ligjore për arkëtimin e shumës **150,000 lekë**, prej përfituesit òA.Aò Shpk, për shpenzime të paargumentuara dhe antiligjore, në të kundërt shuma të çdëmtohet nga personat përgjegjës.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.** **Në zbatim të këtij rekomandimi është dërguar shkresa me nr. 886/2, datë 13.10.2021 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH për subjektin A.A Shpk është lenë afati prej 30 ditë për arkëtimin e shumës prej 150.000 lekë. Subjekti rezulton të ketë kryer likuidimin e detyrimit në buxhetin e shtetit nëpërmjet faturës për arketim dhe mandatit te pagesës në datë 6.12.2021.**

**Rekomandimi 3.** AKZM të marrë masa për njoftimin dhe arkëtimin e detyrimeve nga 8 subjekte në vlerën 9,121,759 lekë *respektivisht:* detyrimeve të prapambetura për 8 subjekte në shumën 9,121,759 lekë, të trashëguara nga Ish/DSHPT evidentuara si më poshtë.

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.** **Në zbatim të këtij rekomandimi është dërguar shkresa me nr. 886/2, datë 13.10.2021 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH për subjektin.**

**2.5. Zbatimi i rekomandimeve për masat 3E. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve:** sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI ËMBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021Ë NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONAVE TË MBROJTURA

**Rekomandim 1:** Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e rasteve, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me efekt negativ për vlerën **3,132,776 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për shërbimin civil ÷ krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike si kodit të punës.

*Komente: Kjo do të masë do të konsiderohet në proces, për arsye nuk janë evidentuar ende raste për zbatimin e rekomandimit.*

### **2.6. Zbatimi i rekomandimeve për masat disiplinore dhe administrative.**

**Komente:** Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë urdhri me nr. 900 datë 3.8.2021 “Për dhënien e masave disiplinore për 3 persona përgjegjës” me masë disiplinore 1 Vërejtje dhe 2 “Vërejtje me paralajmërim”.

## **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME**

1. **Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet një nivel të lartë të zbatimit të rekomandimeve dhe janë marrë masa nga titullari i institucionit, përmes urdhrave dhe ngritjes së grupeve të punës për zbatimin e tyre. Në lidhje me rekomandimin për hartimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e pikave të hyrjes së vizitorëve dhe automjeteve në monumentin e natyrës, objekti i rregullores duhet të jetë mbi:

1. Mbajtjen e korrespondencës dhe administrimin e dokumenteve të krijuara apo të ardhura në adresë të Administratave Rajonale të Zonave të mbrojtura. dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

2. Përgjegjësitë e AKZM-së dhe AdZM-ve përkatëse në administrimin e këtij procesi.

Përcaktimin e procedurës për arkëtimin e të ardhurave nga pikat e hyrjes së vizitorëve dhe automjeteve në zonat e mbrojtura.

**Rekomandim 1.1.** AKZM të marrë masa për hartimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e pikave të hyrjes së vizitorëve dhe automjeteve në monumentin e natyrës.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT